



Prishtinë: 29.01.2008

Kodi i ZRRE-së: V_157_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_170_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_170_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Sevdaim Kaçiu, Minimarket "TONI" (shifra e konsumatorit DPR – 90035494) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 02.11.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 18.10.2007 me numër reference DPR – CO1 – 11 lidhur me transferin e borxhit.

- Me datë 21.04.2004 KEK-u ka bërë Procesin e pranimit të instalimit në emër të konsumatorit Arton Kaçiu "Minimarket TONI" me nr. njehsori 34885503.

Provë: Procesi i pranimit të instalimit të datës 21.04.2004

- Me datë 03.12.2004 KEK-u ka lëshuar një Aktvendim mbi konsumatorin me shifër DPR – 90035494 e nr. njehsori 34885503 mbi ndërprerjen e mëtejme të energjisë elektrike si dhe është kërkuar të riprogramohet borxhi i konsumatorit.

Provë: Aktvendimi i KEK-ut i datës 03.12.2004

- Me datë 09.03.2005 konsumatori ka nënshkruar kontratë për shërbimet e energjisë elektrike me KEK-un.

Provë: Kontrata për shërbimet e energjisë e datës 09.03.2005

- Me datë 09.03.2005 konsumatori ka nënshkruar kontratë për rregullimin e borxhit me KEK-un në shumë prej 507.73 € e më këst mujor prej 37.10 €.

Provë: Kontratë për rregullimin e borxhit e datës 09.03.2005

- Me datë 30.03.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut me rastin e kontrollimit të instalimit tek konsumatori kanë konstatuar se njehsori i konsumatorit nuk ekziston mirëpo pronari ka vendosur njehsor të ri nr. 43683895.



Provë: Procesverballi i KEK-ut nr. 021742 i datës 30.03.2007

- Me datë 23.04.2007 me anë të një dokument të KEK-ut Projekti i Shqyrtimit e konsumatorëve pasiv në CCP - Janar / 2007 ka theksuar që të bëhet transferi i borxhit nga shifrat 29433, 29431 dhe 29434 në shifrën 90035494.

Provë: Projekti i Shqyrtimit e konsumatorëve pasiv në CCP –janar / 2007

- Me datë 23.04.2007 KEK-u me anë të Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 13491 e ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR – 90035494 në shumë prej 2,228.52 €, në të cilin urdhër lejim / është shkruar se: RCO1-x- transfer i borxhit nga shifrat DPR. 29433, DPR. 29431, DPR. 29434 në shifrën DPR. 90035494 sipas procesit të kontrollës nr. 021742 dt. 30.03.2007”.

Provë: Urdhër Lejim / Ngarkim nr. 13491 të datës 23.04.2007

- Me datë 04.05.2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar transferin e borxhit.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- Me datë 18.10.2007 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës nr. 021742 të datës 30.03.2007.

Provë: Përgjigja e KEK-ut

- Me datë 02.11.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, ka vërejtur se:

- ✓ Shifra e konsumatorit DPR – 90035494 e numër njehsori 43683895 është e regjistruar në emër të konsumatorit Sevdaim Kaçiu “Minimarket TONI”.

Provë: Transaksionet e konsumatorit me shifër DPR – 90035494

- ✓ Në procesverbalin e KEK-ut nr. 021742 tek emri i konsumatorit është theksuar Stojanoviq Xhare dhe është theksuar njehsori me nr. 43683895 e me shifër DPR – 29434, DPR – 29431 dhe DPR – 29433.

Provë: Procesverballi nr. 021742 i datës 30.03.2007

- ✓ Shifrat e konsumatorëve DPR – 29434, DPR – 29431 dhe DPR – 29433 kanë qenë të regjistruar në emër të Stojanovic Gjorgje, Stojanovic Rumena dhe Riza Shabani të cilët shihen se sipas transaksioneve kanë pasur borxh ndaj KEK-ut.

Provë: Transaksionet e konsumatorit



- ✓ Me datë 11.12.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kanë dalur në vendin e ngjarjes dhe kanë përpiluar procesverbalin nr. 0900759 me të cilin theksohet se është kontrolluar njehsori dhe se është shkrytur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit në shumë prej 2,900.00 € dhe se njëriën bllob e ka pasur të këputur.

Provë: Procesverbali nr. 090759 i datës 11.12.2007

- ✓ Asnjëra prej shifrave të cekura më lartë prej të cilave KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin nuk ka qenë e regjistruar në emër të konsumatorit dhe se kryesisht borxhi i bartur i përket periudhës para vitit 2004 gjë që ZRRE sipas nenit 32.1 të rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë nuk ka kompetenca me i zgjidh pavarësisht nga tema e kontestit.
- ✓ KEK-u me datën 21.04.2004 ka bërë pranimin e instalimit të njehsorit të këtij lokali. Me këtë rast KEK-u është dashur që të bëjë kontrollin se a ngarkohet ky lokal me borxhe paraprake.
- ✓ Sipas analizës së transaksioneve të shifrave të kontestuara kemi vërejtur se bartja e borxhit e shifrës DPR – 29434 është e periudhës së vitit 2002, bartja e borxhit e shifrës DPR – 29431 është e periudhës e periudhës 02/2005, ndërsa bartja e borxhit e shifrës DPR – 29433 është e periudhës 02/2005. Por duhet theksuar se shifra e konsumatorit DPR – 90035494 e numër njehsori 43683895 është e regjistruar në KEK me datë 21.04.2004 ku fatura e parë konsumatorit i ka arritur në periudhën 05/2004.
- ✓ KEK-u shifrën e konsumatorit DPR – 29434 e regjistruar në emër të Stojanoviq Gjorgje e ka faturuar deri më 11/2002 dhe me datë 23.04.2007 është bërë pasiv, shifra e DPR – 29431 është faturuar deri më 02/2005 dhe se me datë 23.04.2007 është bërë pasiv, shifra e konsumatorit DPR – 29433 është faturuar deri më 02/2005 dhe se me datë 23.04.2007 është bërë pasiv. KEK-ut iu është dashur relativisht një kohë e gjatë për të vërejtur se konsumatorët nuk janë duke jetuar aty.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që të:

1. Shkarkojë menjëherë konsumatorin me shifër DPR – 90035494 nga borxhi i krijuar në shumë prej 2,228.52 € të cilën e ka ngarkuar me anë të urdhër lejimit / ngarkimit nr. 13491.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar